



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 151/2022

Datë: 20 prill 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 13 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 283-të, të mbajtur me datë 20 prill 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e gjyqtarit Avni Sylja për përjashtim si kryesues i panelit hetimor në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/09/2022 /GJTHGJL-GJS-2022-006.
2. Gjyqtari Malësor Kryeziu, anëtari rezervë i të njëjtit panel hetimor, caktohet kryesues.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me 19 prill 2022, ka pranuar përmes postes elektronike kërkesë nga gjyqtari Avni Sylja për përjashtim e tij si kryesues i panelit hetimor në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/09/2022 /GJTHGJL-GJS-2022-006. Kërkesën për përjashtim si kryesues i panelit hetimor në lëndën e lart cekur gjyqtari Sylja e mbështet në atë se si gjyqtar i Departamentit për Krime të Renda është i stërngarkuar me një nume të madh të lëndëve, në mesin e të cilave shumica janë lëndë me paraburgim për të cilat duhet të merren veprime të shpejta. Po ashtu gjyqtari Sylja ka qenë edhe anëtar i komisionit për rekrutim të Bashkëpunëtorëve Profesionale, dhe për shkak të këtij angazhimi i janë paraqitur vështirësi për kryerjen e punëve si gjyqtar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 20 prill 2021, pasi e shqyrtoj kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Avni Sylja si kryesues të panelit hetimor në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/09/2022 /GJTHGJL-GJS-2022-006, vlerësoj se e kërkesa për përjashtim është e arsyeshme dhe njëzëri të njëjtën kërkesë e miratoj.

Këshilli, si kryesues për të shërbyer në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/09/2022/GJTHGJL-GJS-2022-006, caktoj anëtarin rezervë të panelit të njëjtë hetimor gjyqtarin e Gjykatës së Apelit z.Malësor Kryeziu.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Avni Sylja, gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Prishtinë;
- Fatmir Krasniqi, Kryesues i Panelit Hetimor;
- Anëtarëve të Panelit Hetimor